

STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “REGAL RENT” SH.P.K.

Sot, më datë 16.09.2024, ne Ortakët e shoqërisë “REGAL RENT” SH.P.K. Znj.Erta Varrosi dhe Z.Henerik Sadiku, bazuar në vullnetin tonë të lirë themeluan shoqërinë “REGAL RENT”, i ndryshuar, dhe vendosëm të hartojmë këtë statut për funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “REGAL RENT” SH.P.K.

KREU I

THEMELIMI, EMRI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më 16.09.2024, unë themeluesi, krijova shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin:
“REGAL RENT” SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë janë:

Znj.Erta Varrosi, atësia: Përparim, e datëlindjes 18.02.2003, mbajtëse e dokumentit kartë identiteti me numër: 033978393 dhe Numër Personal: K35218040J, banuese në Tiranë, Rruga “Enver Begeja”, Nd.4; H.1, Kutia postare 1012.

Z.Henerik Sadiku, atësia: Sulo, i datëlindjes 01.07.1995, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me numër: 036130107 dhe Numër Personal: J50701077H, banues në Tiranë, Rruga: “Besim Alla”, Nd.ap.8/3; H.shk.2; Kashar; Yzberish, Kutia postare 1052.

Neni 2

Selia

Selia juridike e Shoqërisë, ndodhet në Tiranë, Njësia administrative 14, Rruga: “Sabri Preveza”, Zona Kadastrale 3866, Pasuria Nr.215/266+3-n7, Njësia 7, Kutia postare 1052.
Shoqëria me miratimin e organeve kompetente, mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore të papërcaktuar.

Neni 4 Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Dhënie me qira e makinave, motorëve, minibus, autobus, etj. Tregti, blerje dhe shitje automjete. Shërbime si agjent siguracioni, etj. Shërbime lavazhi, karrotreci, etj. Shërbime të ndryshme menaxhimi, ndërmjetësimi, etj. Organizim guida turistike, udhëtime turistike brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Tregti të ndryshme, etj. Shërbime transporti për materiale, mallra dhe udhëtarë.

Shoqëria mund të kryejë cdo operacion tregtar, si edhe të blejë dhe të shesë ose të marrë me qera ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, të themeluara apo ne themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin, apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera, të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II

KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i shoqërisë është 800 000 (tetëqindmijë) lekë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre, si më poshtë:

Ortakët themelues janë:

Znj. Erta Varrosi, zotëruese e 1 (një) kuote të kapitalit, me vlerë 400 000 (katërqindmijë) lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z. Henerik Sadiku, zotërues i 1 (një) kuote të kapitalit, me vlerë 400 000 (katërqindmijë) lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nga Asambleja e Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve perderisa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimarrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamble në autorizim nga një autorizim nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamble në përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet me shkrese ose mesazh elektronik, duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes, rendin e dites dhe t'u dergohet te gjithë ortakeve jo me vone se para 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur, asambleja e pergjithshme e ortakeve nuk eshte thirrur sipas kesaj menyre, ajo mund te marre njoftime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10
Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 20 % te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 Te Ligjit "Per tregetarët dhe Shoqëritë Tregëtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te votave jane te pranishem personalisht , votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te Nenit 88 te ligjit sipermendur. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite

Neni 11
Marrja e Vendimeve

Asambleja e pergjithshme e Ortakeve, vendos me tre te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera, si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.



Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtroje të drejtën e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nj i perfaqesuar i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njetin konflikt interesi, ashtu sic eshte dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13 Administrimi

Administrator i shoqërisë emërohet:

Znj. Erta Varrosi, atësia: Përparim, e datëlindjes 18.02.2003, mbajtëse e dokumentit kartë identiteti me numër: 033978393 dhe Numër Personal: K35218040J, banuese në Tiranë, Rruga "Enver Begeja", Nd.4; H.1, Kutia postare 1012.

Znj. Erta Varrosi, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare, me të drejtë ripërtëritje.


Administratori i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 14 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme ;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) të kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- f) të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) të kryejnë detyra të tjera të percaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja,



përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin e shoqerise ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

KREU IV

VITI FINANCIAR- EKSPERTËT

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar, fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, miraton Llogaritë vjetore të paraqitura nga Administratori, vendos për krijimin e fondit rezerve, fondeve për investime, si dhe destinime të tjera të fitimit ose humbjes së vitit ushtrimor.

Neni 17 Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla. i ngarkuar nga ana e ortakeve

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

PRISHJA – RIORGANIZMI I SHOQËRISË

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqëri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë: Bashkimi - Ndarja

Shoqëria mund te ndahet , bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se pergjithshme te Asamblese se Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2012 "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare".

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në ketëe statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"REGAL RENT" SH.P.K.:

Erta VARROSI

Erta Varrosi

Jan/24

Henerik SADIKU

Henerik Sadiku

[Signature]